VENDIM
Nr.916, datë 2.7.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË RROGOZHINË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Rrogozhinë, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Rrogozhinë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.16, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Rrogozhinës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Rrogozhinë Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1,2	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
4-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
11,12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
21-23	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
16-20	Varrezat publike	Në pronësi
32-57,59-280,282-285,288,291,292	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
281,343-360,363	Infrastrukturë (sheshe, rrugë	Në pronësi

	vendore, lulishte dhe shërbime publike)	
28	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
13-15	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
26,27	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
364-370	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
371,374,377-379	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
380	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi
325	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e kanalizimeve	Në pronësi